



Datë: 13.08.2025
Numër Protokolli: 5478/2025

A.nr.1171/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Flakron Gashi- në cilësinë e procesmbajtësit ka shqyrtuar ankesën A.nr.1171/2025, të datës 19.06.2025,të parashtruar nga ankuesi F.K, nga Zveçani, kundër organit të punësimit/Komunës së Zveçanit, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 13.08.2025 mori:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e jashtëafatshme ankesa A.nr.1171/2025, e datës 19.06.2025 e parashtruar nga ankuesi F.K.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, F.K (*në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi*), me datë 18.06.2025 përmes emailit ka parashtruar ankesë, e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është regjistruar me datë 19.06.2025 me numër protokolli 4181/2025 nën shenjën A.nr.1171/2025, ndërsa Këshilli me datë 27.06.2025 i është drejtuar ankuesit me kërkesën për sqarime juridike dhe plotësimin e ankesës, respektivisht përcaktimin e aktit që kontestoni dhe organin përkatës që ka nxjerrë aktin në fjalë, kurse përmes e-mailit të datës 30.06.2025 ka dhënë sqarimet e nevojshme ashtu që i njëjti konteston veprimet/mosveprimet e organit të punësimit për kthimin e tij në pozitën “Shef i Zyrës për Komunitete dhe Kthim” në Komunën e Zveçanit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 05.08.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Zveçanit, ndërsa kjo e fundit me datë 07.08.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë lidhur me procedurën në fjalë.

Kryetari i Këshillit, me datë 16.07.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:4770/2025, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjën A.nr.1171/2025 të datës 19.06.2025 ia ka vazhduar afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën të datës 19.06.2025 të parashtruar nga ankuesi në KPMSHCK; Parashtrësën/email i datës 30.06.2025 dërguar nga ankuesi në Këshill; Kërkesën e datës 27.06.2025 dërguar nga Këshilli për ankuesin; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Vendimin e datës 11.05.2022 të Kryetarit të Komunës së Zveçanit; Kërkesën e datës 09.10.2023 të Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL-së; Kërkesën e ankuesit të datës 20.09.2023; Kërkesën e ankuesit të datës 13.09.2023; Kërkesën e ankuesit të datës 14.09.2023; Kërkesën e datës 18.01.2023 të Zëvendësuesen e Sekretares së Përgjithshme të MAPL-së; E-mailin e datës 12.01.2023 dhënë nga Thesari i Kosovës për ankuesin; Shkresë e datës 02.03.2018 e Udhëheqëses së Departamentit ligjor në MAPL; Kartelë financiare e ankuesit; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 05.08.2025; Përgjigje në ankesë e datës 07.08.2025; Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 11.09.2024; Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 23.06.2025; Vendimin e datës 18.10.2023 të Kryetarit të Komunës; Vendimin i Kryetari të Komunës i datës (e pa identifikueshme) për pezullimin e dakorduar të marrëdhënies së punës; Akt emërimit të datës 01.06.2014 të zyrtarit L.P, Akt emërimit të zyrtarit L.P të datës 25.06.2025; Vendimin e Këshillit të datës 28.12.2023 me shifër A.nr.1420/2023; Vendimin e Kryetarit të Këshillit i datës 16.07.2025

Kolegji i Këshillit, pas analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit në këtë fazë **është e jashtëafatshme, sepse:**

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi është i punësuar në Komunën e Zveçanit, gjegjësisht sipas Vendimit Nr.149/23 të datës 18.10.2023 të kryetarit të Komunës së Zveçanit ankuesi është transferuar në mënyrë të përhershme në pozitën *“Udhëheqës i Sektorit të Pylltarisë në kuadër të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim.”*

Po ashtu, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesi sipas Vendimit nr:32/2022 të datës 11.05.2022 të nxjerrë nga Kryetari i Komunës së Zveçanit e kishte pezulluar pozitën e punës *“Shef i Zyrës për Komunitete dhe Kthim”*, mirëpo Kolegji i Këshillit po ashtu konstatoi faktin se akti në fjalë i datës 11.05.2022 nuk është i vulosur me vulën zyrtare të institucionit, madje nuk ka as vulë protokolli. Po ashtu, sipas shkresave të lëndës të ofruara nga organi i punësimit pozitën *“Shefi Zyrës për Komunitete dhe Kthim”* sipas akt emërimit të datës 01.06.2014 e ka mbajtur zyrtari L.P, e që të njëjtën pozitë sipas Akt Emërimit të datës 25.06.2025 e mban po ashtu zyrtari L.P.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill me datë 19.06.2025 si dhe plotësimin e saj përmes parashtrësës së datës 30.06.2023, ankuesi pretendon se organi i punësimit e ka transferuar në pozitën *Udhëheqës i Sektorit të Pylltarisë* pa vullnetin e tij, me kërkesën që organi i punësimit duhet ka kthej në pozitën e punës *Shef i Zyrës për Komunitete dhe Kthim*, ngase pozitën në fjalë e kishte pezulluar sipas vendimit të datës 11.05.2022 të Kryetarit të Komunës pasi që i njëjti ishte emëruar Nënkyetar i Komunës për Komunitete. Ankuesi këtë pretendim e mbështet edhe me kërkesën nr.400-49/5 e datës 10.10.2023 të Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL-së.

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, fillimisht konstatoi se Vendimi Nr.149/23 i datës 18.10.2023 i Kryetarit të Komunës së Zveçanit, përmes të cilit akt ankuesi është transferuar në mënyrë të përhershme në pozitën *“Udhëheqës i Sektorit të Pylltarisë në kuadër të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim”*, e ka mbajtur këshillën juridike, respektivisht ankuesi ishte udhëzuar që kundër aktit në fjalë mund të parashtrojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktit.

Ankuesi me datë 16.11.2023, kishte parashtruar ankesë në Këshilli, e cila ishte protokolluar me numër:699/2023, mirëpo në asnjë pjesë të saj, madje as në petitum të ankesës, Vendimi Nr.149/23 i datës 18.10.2023 i Kryetarit të Komunës së Zveçanit, nuk ishte kontestuar, akt ky përmes të cilit ankuesi është transferuar në mënyrë të përhershme në pozitën “Udhëheqës i Sektorit të Pylltarisë”, ndërsa ankuesi me datë 28.12.2023 përmes parashtrësës me numër protokolli:7690/2023 është tërhequr nga ankesa e tij e datës 16.11.2023, dhe për rrjedhojë Këshilli me datë 28.12.2023 përmes vendimit A.nr.1420/2023 e ka përfunduar procedimin e filluar administrimit sipas ankesës së datës 16.11.2023.

Mbi bazën e konstatimit të dhënë si më lartë, Kolegji i Këshillit mori përbazë dispozitat e aplikuara nga neni 127 paragrafi 1, dhe neni 144 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “**1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.1. skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar**”, nga rrjedh se akti në fjalë është bërë i ekzekutueshëm, ndërsa ankesa e parashtruar me datë 19.06.2025 në Këshill, me qëllim të kthimit në pozitën Shef i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, gjegjësisht kundër vendimit të datës 18.10.2023 të kryetarit të Komunës është ankesë e parashtruar jashtë afatit, ngase nga shkresat e lëndës, respektivisht ankesës së datës 19.06.2025 lë të kuptojë se ankuesi për aktin e datës 18.10.2023 dhe pasojat e tij juridike ka qenë i informuar.

Theksuar si me lart, Kolegji i Këshillit duke u bazuar ne nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe nenin 129 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1171/2025, datë 13/08/2025.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit F.K;
- Komunës së Zveçanit (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.